



# Partia Demokratike

## SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 166prot.

Tiranë, më: 21 /08/2024

**Lënda:** Kërkesë për dhënie informacioni.

**Drejtuar:** **Z. Petrit MALAJ**  
Ministër i Financave

**Z.Genti GAZHELI**  
Drejtor i Përgjithshëm i Doganave

**Z.Kreshnik BAJRAKTARI**  
Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës

**Zj.Elidjana ÇELAJ**  
Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve

Të nderuar,

Në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Shqipërisë si dhe në përmbushje të detyrës sime si deputet, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit“, i ndryshuar, ku specifikohet se: “Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, nga ministrat ose nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore, si dhe nga drejtuesit e çdo institucioni tjetër në administratën publike ose të qeverisjes vendore. Drejtuesit e institucioneve janë të detyruar t’i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës”, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion:

**Praktikën e plotë ligjore me dokumentat respektive të ndjekur deri tani lidhur me dy anijet (Maersk Campton me 40 kontenerë dhe Maersk CANDOR me 60 kontenerë) të ngarkuara me mbetje të dëmshme drejt Tajlandës të cilat do të rikthehen në Shqipëri.**

**Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1, 2, 3 dhe 4 më lart, të jetë i njehsuar me originalin dhe në shkresën përcjellëse të listohet çdo dokument me emërtimin e tij dhe numrin e faqeve përkatëse. Lista e dokumentacionit kërkohet të jetë e nënshkruar dhe vulosur.**

Në rrjedhë e vijim të asaj çfarë përçon neni 7 i Kushtetutës, përmes kushtëzimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, për një përvijim marrëdhëniesh ligjore në funksionin e kontrollit parlamentar, që nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë si dhe nxjerrjen e përgjegjësive, sipas rasteve konkrete. Të gjitha çështjet që përmbajnë në vetvete një interes publik përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar. Në këtë rast, ligjshmëria dhe transparencja është një kërkesë e domosdoshme për mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe qytetarëve, si një nga detyrat themelore të organeve publike.

Nisur nga sa sipër dhe qëllimit për ruajtjen e një balance të drejtë të respektimit të standardeve të shtetit të së drejtës si dhe qeverisjes transparente, mbetem në pritje të mbërritjes së informacionit tuaj, brenda afatit ligjor 15 (pesëmbëdhjetë) ditor.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

**Flamur NOKA**

